



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

NJËSIA E HARTIMIT TË DOKUMENTAVE TË TENDERIT

Nr. _____ prot.

Himarë , më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstrukcion i shkallëve Stefanel, loti II”

2.1 KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shkallë 44233000-2, Punime ndërtimi 45210000-2

VLERA E FONDIT: 3 895 780,38 (tre milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë presje tridhjetë e tetë lekë) **Lekë pa TVSH**

Përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj”, Inxhinieri është mbështetur në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor: **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga organet kompetente, e cila duhet të përfshijë kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- *NP-1 A – Punime gjurmimi në tokë;*
- *NP-4 A – Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale;*
- *NP-12 A – Punime të inxhinierisë së mjedisit.*

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- *NS-18 A – Punime topogjeodezike.*

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit që, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit, merr përsipër të realizojë.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë, të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (ose ministrisë kompetente të kohës) në Republikën e Shqipërisë, referuar VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se ”1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”, nenin 39, pika 6, gërma (a), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”6. Për të provuar

përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”, Ligjin Nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998 të ndryshuar, VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar.

Në bazë të licencës profesionale të shoqërisë tregohet aftësia teknike e profesionale e realizimit të kontratës që prokurohet dhe pikat e kërkuara të licensës janë përcaktuar nga vlera e punimeve që do të realizohen si dhe nisur nga natyra e punëve që do të kryhen sipas zërave të preventivit. Nisur nga fakti që vlera e objektit është më e vogël se 20 milion lekë për kategoritë e punimeve, është zgjedhur niveli i klasifikimit ”A” që i përgjigjet kësaj vlere.

Bazuar në natyrën, llojin dhe volumin e punimeve të parashikuara në preventiv, kategoritë e licencave të kërkuara janë të lidhura drejtpërdrejt me zërat konkretë të punimeve që do të realizohen dhe me kapacitetet teknike e profesionale të nevojshme për zbatimin e tyre.

Kategoria NP-1 A: Punime gjërmimi në tokë. Kjo kategori licence justifikohet nga përfshirja në preventiv e punimeve të gjërmimit të dheut, si dhe e punimeve për përgatitjen dhe sistemimin e terrenit përpara realizimit të shtresave konstruktive. Në mënyrë konkrete, në preventiv janë parashikuar zëra si gjërmim dheu me krah dhe gjërmim dheu me ekskavator, të cilët përbëjnë punime tipike të kësaj kategorie. Këto punime janë të nevojshme për heqjen e materialeve ekzistuese, krijimin e niveleve dhe kuotave të projektit, përgatitjen e bazamentit dhe formimin e trupit të sipërfaqes ku do të realizohen shtresat e reja. Gjërimit lidhen gjithashtu me punimet e mbingritjes dhe të sistemimit të pueseve ekzistuese, si dhe me përgatitjen e terrenit për vendosjen e shtresës së stabilizantit, shtresës së betonit dhe shtrimit me kalldrëm. Për këtë arsye, disponimi i licencës NP-1 A është i nevojshëm për të garantuar realizimin teknikisht korrekt dhe të sigurt të punimeve të gjërmimit dhe përgatitjes së terrenit.

Kategoria NP-4 A: Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale. Kjo kategori lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve të parashikuara për ndërtimin, rikonstruksionin dhe sistemimin e sipërfaqeve të qarkullimit dhe hapësirave të infrastrukturës. Në preventiv janë parashikuar shtresë stabilizanti, shtresë betoni C16/20 dhe shtrim kalldrëmi me gurin e zonës, të cilat përbëjnë elemente konstruktive të rëndësishme për krijimin dhe rehabilitimin e sipërfaqeve të qëndrueshme të qarkullimit.

Gjithashtu, punimet e prishjes së shtresave të betonit dhe strukturave prej guri, të ndjekura nga punimet e gjërmimit, transportit të materialeve, përgatitjes së bazamentit dhe realizimit të shtresave të reja, tregojnë se objekti përfshin ndërhyrje të plota në strukturën ekzistuese të infrastrukturës. Shtrimi me kalldrëm me gurin e zonës, i realizuar mbi shtresa të përgatitura dhe të stabilizuara, përbën një ndërhyrje në sipërfaqe të destinuara për qarkullim dhe përdorim publik dhe kërkon kapacitete profesionale për realizimin e shtresave mbajtëse dhe përfundimtare. Për rrjedhojë, kërkesa për licencën NP-4 A është e lidhur drejtpërdrejt me zërat e preventivit dhe me natyrën infrastrukturore të punimeve që do të realizohen.

Kategoria NP-12 A: Punime të inxhinierisë së mjedisit. Kategoria NP-12 A duhet të lidhet me aspektet e sistemimit dhe ndërhyrjes në terren që shoqërojnë punimet e parashikuara në preventiv. Në këtë kuadër, punimet e gjurmimit të dheut, transportit të materialeve, mbingritjes dhe sistemimit të pueseve ekzistuese, së bashku me realizimin e shtresave të reja të stabilizuara dhe sipërfaqeve përfundimtare, ndikojnë në sistemimin dhe rehabilitimin e terrenit dhe në përmirësimin e funksionalitetit të hapësirës. Punimet e prishjes së strukturave ekzistuese prej betoni dhe guri, largimi dhe transporti i materialeve të rezultuara nga prishjet, si dhe rikrijimi i shtresave konstruktive, synojnë eliminimin e elementeve të amortizuara dhe rehabilitimin e sipërfaqes ekzistuese. Në veçanti, përdorimi i shtresës së stabilizantit, shtresës së betonit dhe realizimi i shtrimit me gur natyral kontribuojnë në stabilizimin e terrenit, kontrollin e degradimit të sipërfaqes dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë së infrastrukturës ndaj veprimit të faktorëve atmosferikë dhe ujërave sipërfaqësore. Në këtë kuptim, kërkesa për kategorinë NP-12 A lidhet me nevojën për kapacitete teknike dhe profesionale për realizimin e ndërhyrjeve të sistemimit dhe rehabilitimit të terrenit, duke siguruar që punimet të kryhen në mënyrë të qëndrueshme dhe në përputhje me kërkesat teknike të objektit.

Kategoria NS-18 A: Punime topogjeodezike. Kategoria NS-18 A lidhet me nevojën për realizimin e piktimit, matjeve topografike, përcaktimit të kuotave dhe kontrollit të niveleve dhe akseve gjatë zbatimit të punimeve. Duke qenë se objekti përfshin gjurmime dheu me krah dhe me ekskavator, mbingritje, sistemim të pueseve ekzistuese, realizim të shtresës së stabilizantit, shtresës së betonit C16/20 dhe shtrim të kalldrëmit me gurin e zonës, respektimi i kuotave dhe niveleve të përcaktuara është thelbësor për realizimin korrekt të veprës. Punimet topogjeodezike janë të nevojshme për përcaktimin dhe kontrollin e niveleve të gjurmimit, trashësive të shtresave, kuotave të përfundimit dhe pjerrësive të sipërfaqeve të shtruara. Ato sigurojnë gjithashtu kontrollin e saktësisë së pozicionimit të elementeve të reja dhe përputhjen e tyre me projektin. Për këtë arsye, disponimi i kategorisë NS-18 A lidhet me nevojën për kontrollin teknik dhe topografik të punimeve gjatë gjithë procesit të zbatimit, duke garantuar respektimin e kuotave, niveleve dhe parametrave gjeometrikë të përcaktuar në projekt.

Në tërësi, kategoritë NP-1 A, NP-4 A, NP-12 A dhe NS-18 A lidhen me natyrën konkrete të punimeve të parashikuara në preventiv, përkatësisht me prishjen e shtresave dhe strukturave ekzistuese, gjurmimet e dheut, transportin e materialeve, mbingritjen dhe sistemimin e pueseve ekzistuese, realizimin e shtresave konstruktive, vendosjen e hekurit periodik Ø6–10 mm, betonimin me beton C16/20 dhe shtrimin përfundimtar me kalldrëm prej guri të zonës.

Kërkesa për këto kategori licencash synon të sigurojë që operatori ekonomik të disponojë kapacitetet e nevojshme profesionale, teknike dhe organizative për realizimin e punimeve sipas kërkesave të projektit, standardeve teknike dhe kushteve të zbatimit, duke garantuar cilësinë, qëndrueshmërinë dhe sigurinë e veprës.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të

periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “*Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...*”; nenin 43 pika 2/c dhe pika 3, nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku parashikohen se:

“2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme”.

“3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor”.

“Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedurë prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”.*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”.*

Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros*

së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron është vendosur konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për:

- një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 29 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 95 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së kryer.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së kryer, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore si dhe me situacionet e punimeve dhe akt-kolaudimin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se ”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ku parashikohet se ”Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: a) Për kontratat e punëve:

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 29 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Referuar nenit 55 pika 4 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, është përcaktuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 29 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Përcaktimi i vlerës minimale prej 95% të vlerës limit të kontratës synon të sigurojë që operatori ekonomik të ketë një eksperiencë reale dhe të konsoliduar në realizimin e punimeve të ngjashme, në një volum ekonomik të konsiderueshëm dhe të krahasueshëm me përmasat e kontratës objekt prokurimi. Ky nivel kërkesë është i arsyeshëm duke pasur parasysh se kontrata përfshin një kombinim të punimeve të prishjes, gërmimit, transportit, ndërtimit të shtresave konstruktive, betonimit dhe shtrimit të sipërfaqeve me gur natyral.

Kërkesa është vendosur duke respektuar përcaktimin ligjor sipas të cilit, për kontratat e punëve në procedurat e thjeshtuara, vlera e punëve të ngjashme të kërkuara në total gjatë pesë viteve të fundit nuk duhet të jetë më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Në rastin konkret, kërkesa prej 95% është më e ulët se kufiri maksimal prej 100% të vlerës limit të kontratës dhe, për rrjedhojë, qëndron brenda kufirit të përcaktuar nga kuadri ligjor.

Në përputhje me përcaktimin ligjor, kriteri është konceptuar në mënyrë alternative, duke parashikuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve të përvojës së ngjashme e bën ofertën të kualifikueshme. Për rrjedhojë, operatorët ekonomikë kanë mundësi të dëshmojnë kapacitetin e tyre profesional ose nëpërmjet realizimit të një pune të ngjashme për një objekt të vetëm, brenda kufirit të përcaktuar përkatësisht nga legjislacioni, ose nëpërmjet realizimit të disa punëve të ngjashme, vlera monetare totale e të cilave plotëson pragun e kërkuar.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore, për muajin Korrik 2026, prej minimalisht 8 (tetë) personash.

Kriteri do të vërtetohet me:

a) vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore;

b) listëpagesa e punonjësve, të konfirmuar nga autoritetet përkatëse, të shoqëruara me formularët e deklaratimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e

zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë, për muajin Korrik 2026, minimalisht 8 (tetë) punonjës, është përcaktuar mbi bazën e analizës së natyrës, llojit dhe volumeve të punimeve të parashikuara në preventiv, si dhe të proceseve të ndryshme të punës që kërkojnë angazhim të njëkohshëm të punonjësve në kantier.

Objekti i kontratës përfshin punime prishjeje, gjurmimi, transporti dhe sistemimi të materialeve, punime të shtresave konstruktive, betonarmeje dhe shtrimi me gur natyral. Për realizimin e këtyre punimeve në mënyrë të organizuar dhe brenda afatit kontraktor, është e nevojshme që operatori ekonomik të disponojë një numër minimal punonjësish që mundëson zhvillimin paralel të proceseve të punës dhe shmangien e ndërprerjeve apo vonesave në realizimin e punimeve.

Në fazën fillestare realizohen punimet e prishjes së shtresave të betonit dhe strukturave prej guri, si dhe gjurmimet e dheut me krah dhe me ekskavator. Për këto procese kërkohet angazhimi i punonjësve për prishjen manuale, sistemimin dhe ngarkimin e materialeve, orientimin dhe ndihmën gjatë punës së ekskavatorit, si dhe përgatitjen e sipërfaqes për fazat pasuese.

Njëkohësisht, është i nevojshëm angazhimi i punonjësve për transportin dhe largimin e materialeve të rezultuara nga prishjet dhe gjurmimet, si dhe për furnizimin e kantierit me materialet e nevojshme. Këto procese nuk mund të realizohen në mënyrë efikase nga një numër shumë i kufizuar punonjësish, pasi zhvillohen paralelisht me punimet e prishjes dhe gjurmimit.

Në vijim, pas përfundimit të punimeve të gjurmimit dhe përgatitjes së bazamentit, realizohet shtresa e stabilizantit, e cila kërkon shpërndarjen, nivelimin, sistemimin dhe përgatitjen e saj për shtresat e mëtejshme konstruktive. Ky proces shoqërohet me nevojën për kontroll dhe punë manuale në kantier.

Në fazën e punimeve të betonarmesë parashikohet shtresë betoni C16/20 dhe vendosje hekuri periodik Ø6–10 mm. Këto procese kërkojnë punonjës për përgatitjen dhe vendosjen e armaturës, pozicionimin dhe fiksimin e hekurit, përgatitjen e sipërfaqes dhe realizimin e betonimit, si dhe për sistemimin dhe përfundimin e betonit. Për shkak të natyrës së këtyre proceseve, është e nevojshme që një pjesë e fuqisë punëtore të jetë e angazhuar në mënyrë të përqendruar në punimet e betonarmesë.

Në fazën përfundimtare realizohet shtrimi i kalldrëmit me gurin e zonës, i cili kërkon punonjës për përgatitjen dhe nivelimin e sipërfaqes, përzgjedhjen dhe vendosjen e gurëve, përshtatjen e tyre, mbushjen e fugave dhe realizimin e përfundimeve. Ky proces kërkon punë manuale dhe kujdes të veçantë për respektimin e niveleve, pjerrësive, drejtimit dhe cilësisë së sipërfaqes së përfunduar.

Duke marrë në konsideratë mundësinë e zhvillimit paralel të proceseve të prishjes, gjurmimit, transportit, përgatitjes së shtresave, punimeve të betonarmesë dhe shtrimit me gur, organizimi minimal i fuqisë punëtore vlerësohet si më poshtë:

- 2 punonjës për punimet e prishjes së shtresave të betonit dhe strukturave prej guri, si dhe punimet e gërmimit manual;
 - 1 punonjës për transportin, sistemimin dhe largimin e materialeve të rezultuara nga prishjet dhe gërmimet;
 - 2 punonjës për realizimin e shtresës së stabilizantit dhe përgatitjen e bazamentit;
 - 2 punonjës për vendosjen e hekurit periodik Ø6–10 mm dhe realizimin e shtresës së betonit C16/20;
 - 1 punonjës për punimet e shtrimit të kalldrëmit me gurin e zonës dhe punimet e përfundimit.
- Në total rezultojnë 8 (tetë) punonjës, të cilët përfaqësojnë nivelin minimal të fuqisë punëtore që Autoriteti Kontraktor vlerëson të nevojshëm për organizimin dhe zhvillimin normal të punimeve. Kjo kërkesë nuk nënkupton që të gjithë punonjësit duhet të jenë të angazhuar në të njëjtin proces pune gjatë gjithë periudhës së kontratës, por synon të garantojë që operatori ekonomik të ketë në dispozicion burimet minimale njerëzore të nevojshme për përballimin e proceseve të ndryshme të punës dhe, kur është e nevojshme, zhvillimin e tyre në mënyrë paralele.
- Përcaktimi i fuqisë minimale prej 8 punonjësish është në përpjesëtim me volumin dhe natyrën e punimeve të parashikuara në preventiv dhe është i nevojshëm për garantimin e realizimit të kontratës me cilësi, në përputhje me specifikimet teknike dhe brenda afatit të përcaktuar.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë personelin teknik, të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe që figuron në listëpagesat e shoqërisë, si më poshtë:

- *1 (një) inxhinier ndërtimi;*

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomë, kontratë pune, CV dhe librezë pune. Disponimi i personelit teknik të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”, në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”

parashikohet: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”*

Kërkesa që operatori ekonomik pjesëmarrës të disponojë 1 (një) inxhinier ndërtimi, të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe që figuron në listëpagesat e saj, është përcaktuar në funksion të garantimit të realizimit të punimeve në përputhje me projektin e zbatimit, preventivin, specifikimet teknike, standardet teknike të ndërtimit dhe legjislacionin në fuqi. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit dhe është proporcionale me llojin, volumin dhe kompleksitetin e punimeve që do të realizohen.

Referuar preventivit, objekti përfshin një sërë punimesh ndërtimore dhe rehabilituese, konkretisht prishje të shtresave të betonit, prishje të strukturave prej guri, mbingritje të puseve ekzistuese, gjermim dheu me krah dhe me ekskavator, transport materialesh, realizim të shtresës së stabilizantit, shtresë betoni C16/20, vendosje të hekurit periodik Ø6–10 mm dhe shtrim kalldrëmi me gurin e zonës.

Këto punime kërkojnë organizim dhe kontroll teknik të vazhdueshëm, veçanërisht gjatë fazave të gjermimit, përgatitjes së bazamentit, realizimit të shtresave konstruktive, vendosjes së armaturës, betonimit dhe përfundimit të sipërfaqeve. Për këtë arsye, disponimi i një inxhinieri ndërtimi është i nevojshëm për të garantuar që proceset e zbatimit të kryhen sipas kërkesave teknike dhe parametrave të përcaktuar në projekt.

Inxhinieri i ndërtimit do të ketë rol në organizimin dhe koordinimin teknik të punimeve, kontrollin e zbatimit të projektit, verifikimin e kuotave dhe niveleve të punimeve, kontrollin e përgatitjes së bazamentit, mbikëqyrjen e vendosjes së armaturës periodike Ø6–10 mm, kontrollin e punimeve të betonimit me beton C16/20, si dhe kontrollin e cilësisë dhe përputhshmërisë së materialeve të përdorura.

Gjithashtu, duke qenë se punimet përfshijnë ndërhyrje në terren dhe realizimin e shtresave konstruktive, inxhinieri i ndërtimit është i nevojshëm për të kontrolluar qëndrueshmërinë dhe cilësinë e bazamentit, trashësitë dhe nivelimin e shtresave, si dhe respektimin e parametrave teknike gjatë shtrimit të kalldrëmit me gurin e zonës.

Prania e këtij specialisti është veçanërisht e rëndësishme për koordinimin e punimeve të ndryshme dhe për evidentimin në kohë të problematikave teknike që mund të lindin gjatë zbatimit, duke synuar shmangien e defekteve, ripunimeve dhe vonesave në realizimin e kontratës.

Kërkesa që inxhinieri i ndërtimit të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të figurojë në listëpagesat e saj synon të garantojë se operatori ekonomik disponon realisht kapacitetin profesional dhe teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës dhe se personeli i deklaruar nuk është angazhuar vetëm formalisht për qëllime të pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit.

Për sa më sipër, kërkesa për disponimin e 1 (një) inxhinieri ndërtimi vlerësohet e nevojshme, objektive dhe proporcionale me natyrën dhe volumin e punimeve objekt prokurimi, pasi garanton praninë e kapacitetit profesional të specializuar për kontrollin dhe realizimin e punimeve ndërtimore në përputhje me projektin, specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomë, kontratë pune, CV dhe librezë pune, dokumentacion i cili shërben për të provuar kualifikimin

arsimor, marrëdhënien e punës, eksperiencën profesionale dhe disponimin real të specialistit të kërkuar.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë personelin teknik dhe punonjësit e nevojshëm për realizimin e kontratës, të cilët duhet të jenë të kualifikuar sipas profileve përkatëse dhe të rezultojnë të punësuar pranë operatorit ekonomik, sipas legjislacionit në fuqi.

Për realizimin e punimeve objekt prokurimi, operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht personelin e mëposhtëm:

- 1 (një) betonues
- 1 (një) hekurkthyes
- 1 (një) murator/gurëgdhendës
- 1 (një) karpentier
- 1 (një) teknik ndërtimi
- 1 (një) elektrikist
- 1 (një) eskavatorist (i cili mund të disponohet nga OE edhe nëpërmjet kontraktimit).
- 1 (një) shofer
- 1 (një) punëtor ndërtimi.

Disponimi i personelit të mësipërm deklarohet nga operatori ekonomik në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Operatori ekonomik i renditur i pari paraqet dokumentacionin provues, si më poshtë:

- a) Kontratat individuale të punës, të vlefshme sipas legjislacionit në fuqi;*
- b) Listëpagesat e sigurimeve shoqërore (E-Sig), për muajin Korrik 2026, ku të rezultojë punësimi i personelit të kërkuar;*
- c) Për operatorët e mjeteve, dëshmi të aftësisë profesionale ose leje drejtimi të kategorisë përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.*

Për operatorët e mjeteve të rënda, dëshmitë e aftësisë profesionale duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi për përdorimin e makinerive të rënda të ndërtimit.

Në rast se mjetet e kërkuara janë marrë me qira nga persona fizikë ose juridikë dhe shoqërohen me operatorët përkatës, drejtuesit e mjeteve që vihen në dispozicion së bashku me mjetet nuk është e nevojshme të figurojnë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues. Në këtë rast, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin që provon disponimin e mjetit dhe të operatorit të tij, sipas marrëveshjes së qirasë ose kontratës përkatëse.

Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit operatori ekonomik deklaron për operatorët e mjeteve: emrin dhe mbiemrin, profilin e punës, datën e kontratës së punës ose të marrëveshjes përkatëse, numrin e dëshmisë së aftësisë profesionale dhe afatin e vlefshmërisë së saj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë

një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit” si dhe VKM Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", Urdhërin Nr. 109, datë 05.08.2013 ”Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”.

Kërkesa për disponimin e personelit teknik dhe punonjësve të specializuar është përcaktuar në funksion të natyrës, volumit dhe kompleksitetit të punimeve objekt kontrate, me qëllim garantimin e realizimit të tyre në përputhje me projektin e zbatimit, preventivin, specifikimet teknike, standardet e ndërtimit dhe afatet e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Numri dhe profilet e kërkuara janë përcaktuar mbi bazën e analizës së zërave konkretë të preventivit dhe proceseve teknike që duhet të zhvillohen gjatë zbatimit të kontratës.

Objekti i kontratës përfshin punime prishjeje, gërmimi, transporti dhe sistemimi, realizimin e shtresave konstruktive, punime betonarmeje, vendosje armature, punime karpenterie, shtrim dhe veshje me gur, si dhe punime elektrike. Këto procese kërkojnë angazhimin e punonjësve me profile të ndryshme profesionale, pasi përmbajnë procese teknike të specializuara që nuk mund të realizohen në mënyrë të përshtatshme vetëm nga punonjës të pakualifikuar.

Kërkesa për 1 (një) betonues lidhet drejtpërdrejt me realizimin e punimeve me shtresë betoni C16/20, të cilat kërkojnë përgatitjen e bazamentit, përhapjen dhe sistemimin e betonit, nivelimin dhe përfundimin e sipërfaqes. Angazhimi i një betonuesi mundëson zhvillimin e njëkohshëm të proceseve të betonimit dhe përfundimit të sipërfaqes, duke garantuar ritmin dhe cilësinë e kërkuar të punimeve.

Kërkesa për 1 (një) hekurkthyes është e lidhur me zërin e preventivit që parashikon vendosjen e hekurit periodik Ø6–10 mm. Punimet e armaturës përfshijnë përgatitjen, prerjen, përkuljen, pozicionimin dhe lidhjen e hekurit sipas detajeve dhe kërkesave të projektit. Disponimi i një punonjësi të specializuar në këtë profil është i nevojshëm për garantimin e saktësisë së armimit dhe respektimin e parametrave konstruktivë.

Kërkesa për 1 (një) murator/gurëgdhendës lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me zërin “shtrim kalldrëm me gurin e zonës”. Ky proces kërkon përgatitjen dhe nivelimin e bazës, përzgjedhjen dhe vendosjen e gurëve, përshtatjen e tyre, krijimin e fugave dhe realizimin e përfundimeve. Duke qenë se shtrimi me gur natyral është një proces kryesisht manual dhe kërkon përvojë specifike në punimin dhe vendosjen e gurit, kërkesa për një murator/gurëgdhendës është e nevojshme për garantimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së punimeve me kërkesat teknike.

Kërkesa për 1 (një) karpentier lidhet me punimet përgatitore dhe realizimin e kallëpeve të nevojshme për elementët prej betoni. Karpentieri është përgjegjës për përgatitjen, montimin, fiksimin dhe çmontimin e kallëpeve, duke garantuar respektimin e dimensioneve, niveleve dhe formës së elementëve betonikë. Cilësia dhe qëndrueshmëria e kallëpeve ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe saktësinë gjeometrike të punimeve të betonit.

Kërkesa për 1 (një) teknik ndërtimi është përcaktuar me qëllim garantimin e organizimit dhe ndjekjes së përditshme të punimeve në kantier. Tekniku i ndërtimit do të kontribuojë në koordinimin e ekipeve të punës, ndjekjen e grafikut të zbatimit, kontrollin e proceseve të punës dhe evidentimin e problematikave teknike gjatë realizimit të punimeve. Ky profil shërben si një element i rëndësishëm koordinues ndërmjet organizimit të kantierit dhe punonjësve të specializuar. Kërkesa për 1 (një) elektrikist lidhet me zërat e preventivit që kanë të bëjnë me realizimin e elementëve dhe instalimeve elektrike të nevojshme për objektin. Punimet elektrike kërkojnë njohuri dhe aftësi specifike për realizimin dhe kontrollin e instalimeve, lidhjeve dhe elementëve elektrikë, në mënyrë që ato të kryhen në përputhje me projektin, specifikimet teknike dhe kërkesat e sigurisë në punë.

Kërkesa për 1 (një) eskavatorist lidhet drejtpërdrejt me zërin e preventivit “gërmim dheu me eskavator”. Realizimi i gërmimeve mekanike dhe sistemimi i materialeve me mjete të rënda kërkon operator të aftë dhe të kualifikuar për përdorimin e makinerive përkatëse. Për këtë arsye, disponimi i një eskavatoristi është i nevojshëm për garantimin e realizimit të sigurt dhe teknikisht korrekt të punimeve mekanike. Për shkak të natyrës së këtij funksioni, operatori ekonomik mund ta disponojë eskavatoristin edhe nëpërmjet kontraktimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kërkesa për 1 (një) shofer lidhet me nevojën për transportin e materialeve të ndërtimit dhe largimin e materialeve të rezultuara nga punimet e prishjes dhe gërmimit. Në preventiv parashikohet transport materialeve, ndërsa gjatë zbatimit do të jetë e nevojshme furnizimi i vazhdueshëm i kantierit me stabilizant, beton, gur dhe materiale të tjera. Disponimi i një shoferi siguron vijueshmërinë e transportit dhe furnizimit të kantierit dhe ndihmon në respektimin e grafikut të punimeve.

Kërkesa për 1 (një) punëtor ndërtimi është përcaktuar për të mbështetur proceset e ndryshme të punës që kërkojnë angazhim manual dhe që shoqërojnë punimet e prishjes, gërmimit, transportit, sistemimit të materialeve, përgatitjes së sipërfaqeve dhe punimeve përfundimtare. Punëtori i ndërtimit mund të angazhohet në procese ndihmëse sipas fazës së zbatimit, duke siguruar fleksibilitet dhe vijueshmëri të punimeve në kantier.

Në tërësi, kërkesa për punonjës, sipas profileve të përcaktuara, është rezultat i analizës së proceseve konkrete të punës dhe nevojës për zhvillimin e tyre në mënyrë të koordinuar dhe, kur është e nevojshme, paralelisht. Çdo profil lidhet me një ose më shumë zëra konkretë të preventivit dhe me një funksion të përcaktuar në procesin e realizimit të kontratës.

Kjo përbërje minimale e personelit synon të garantojë që punimet e gërmimit dhe transportit të mund të zhvillohen pa penguar proceset e tjera, që punimet e armimit dhe betonimit të realizohen nga punonjës të specializuar, që shtrimi i gurit të kryhet nga personel me aftësitë përkatëse dhe që proceset e organizimit teknik dhe instalimeve elektrike të mbulohen nga profilet përkatëse profesionale.

Kërkesa që personeli i përcaktuar të rezultojë i punësuar pranë operatorit ekonomik, sipas legjislacionit në fuqi, synon të garantojë disponimin real të kapaciteteve njerëzore gjatë

ekzekutimit të kontratës dhe shmangien e deklaramit formal të personelit vetëm për qëllime të kualifikimit në procedurën e prokurimit.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës që provon kualifikimin dhe marrëdhënien e punës të personelit të kërkuar, sipas përcaktimeve të Dokumenteve të Tenderit dhe legjislacionit në fuqi. Për eskavatoristin, i cili mund të disponohet edhe nëpërmjet kontraktimit, duhet të paraqitet dokumentacioni që provon aftësinë profesionale për drejtimin dhe përdorimin e makinerisë përkatëse.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet, makineritë dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e kontratës, në pronësi ose me qira, të përshtatshme për natyrën dhe volumin e punimeve objekt prokurimi, si më poshtë:

<i>Nr.</i>	<i>Lloji i mjetit/makinerisë</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
	<i>Ekskavator ose miniekskavator</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>	<i>1 copë</i>
2	<i>Kamion vetëshkarkues</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>	<i>1 copë</i>
3	<i>Kamionçinë</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>	<i>1 copë</i>
4	<i>Betoniere</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>	<i>1 copë</i>
5	<i>Vibrator betoni</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>	<i>1 copë</i>
6	<i>Gjenerator</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>	<i>1 copë</i>
7	<i>Matrapik</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>	<i>2 copë</i>

Disponimi i mjeteve, makinerive dhe pajisjeve deklarohet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Operatori ekonomik i renditur i pari paraqet dokumentacionin provues si më poshtë:

Për mjetet që regjistrohen në regjistrat publikë:

- lejen e qarkullimit;*
- certifikatën e kontrollit teknik;*
- policën e sigurimit të vlefshme;*
- dokumentacionin që provon disponimin e mjetit.*

Për mjetet e marra me qira:

- kontratën e qirasë ose marrëveshjen e disponimit;*
- dokumentacionin e pronësisë së mjetit;*
- dokumentacionin ligjor të mjetit sipas përcaktimeve të mësipërme.*

Për makineritë dhe pajisjet që nuk regjistrohen në regjistra publikë:

- dokumentacionin që provon pronësinë ose disponimin e tyre.*

Në rast se mjetet e rënda vihen në dispozicion së bashku me operatorët përkatës, operatorët e tyre nuk është e nevojshme të figurojnë në listëpagesat e operatorit ekonomik, por duhet të provohen nëpërmjet kontratës së qirasë ose marrëveshjes së disponimit dhe dokumentacionit përkatës të operatorit.

Operatori ekonomik duhet të disponojë gjithashtu pajisjet minimale të mbrojtjes dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin për sigurinë dhe shëndetin në punë, konkretisht:

- 2 kuti të ndihmës së shpejtë;
- 3 tabela sinjalistike të përkohshme;
- 8 helmeta mbrojtëse;
- 8 jelekë fosforeshentë;
- 2 fiksues zjarri të lëvizshme.

Disponimi i këtyre pajisjeve deklarohet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari paraqet dokumentacionin provues përkatës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

Nëpërmjet kësaj kërkesë, operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Lloji dhe numri i mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës është përcaktuar duke u bazuar në zërat e preventivit dhe specifikimeve teknike. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Përcaktimi i paisjeve dhe makinerive është bërë duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit, mundësive të manovrimit me mjete të rënda, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj.

Kërkesa për disponimin e mjeteve, makinerive dhe pajisjeve është përcaktuar në funksion të natyrës, volumit dhe kompleksitetit të punimeve objekt kontrate, me qëllim garantimin e realizimit të tyre në përputhje me projektin e zbatimit, preventivin, specifikimet teknike dhe afatet e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Mjetet, makineritë dhe pajisjet e kërkuara përfaqësojnë kapacitetin minimal teknik të nevojshëm për realizimin e proceseve të parashikuara në preventiv. Referuar zërave të preventivit, kontrata përfshin prishje të shtresave të betonit dhe strukturave prej guri, mbingritje të puseve ekzistuese, gërmim dheu me krah dhe me ekskavator, transport materiale, realizim të shtresës së stabilizantit, shtresë betoni C16/20, vendosje hekuri periodik

Ø6–10 mm dhe shtrim kalldrëmi me gurin e zonës. Këto procese kërkojnë përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të përshtatshme, pasi një pjesë e punimeve realizohen mekanikisht, ndërsa procese të tjera kërkojnë pajisje të posaçme për betonimin dhe prishjen.

Kërkesa për 1 (një) ekskavator ose miniekskavator lidhet drejtpërdrejt me zërin e preventivit “gërmim dheu me ekskavator” dhe me nevojën për realizimin e gërmimeve mekanike, sistemimin e terrenit, ngarkimin dhe lëvizjen e materialeve të dala nga gërmimet. Pranimi alternativ i një ekskavatori ose miniekskavatori i jep operatorit ekonomik mundësinë të përdorë mjetin më të përshtatshëm sipas kushteve fizike dhe hapësirës së kantierit, duke mos kufizuar në mënyrë të panevojshme konkurrencën. Disponimi i këtij mjeti është i nevojshëm për realizimin e gërmimeve në mënyrë të kontrolluar, të sigurt dhe brenda afatit kontraktor.

Kërkesa për 1 (një) kamion vetëshkarkues lidhet me zërin “transport materiale”, si dhe me nevojën për largimin e materialeve të rezultuara nga prishjet dhe gërmimet dhe furnizimin e kantierit me materialet e nevojshme për realizimin e shtresës së stabilizantit, betonit dhe shtrimit me gur. Kamioni vetëshkarkues mundëson transportin dhe shkarkimin efikas të materialeve inerte, duke garantuar vijueshmërinë e punimeve dhe furnizimin e rregullt të kantierit.

Kërkesa për 1 (një) kamionçinë është përcaktuar për nevojat e transportit të materialeve dhe pajisjeve me volum më të vogël, veglave të punës dhe furnizimeve të ndryshme të kantierit. Ky mjet shërben si mbështetje logjistike për organizimin e përditshëm të punimeve dhe mundëson transportin e shpejtë të materialeve dhe pajisjeve ndërmjet pikave të furnizimit dhe kantierit.

Kërkesa për 1 (një) betoniere lidhet me punimet që kërkojnë përgatitjen dhe përdorimin e betonit ose llaçit në kantier. Në veçanti, realizimi i shtresës së betonit C16/20 dhe punimet shoqëruese kërkojnë mjete të përshtatshme për përgatitjen ose përpunimin e sasive të nevojshme të materialit. Betoniere siguron fleksibilitet në realizimin e punimeve dhe mundëson përgatitjen e sasive të nevojshme në funksion të ritmit të punës dhe kushteve të kantierit.

Kërkesa për 1 (një) vibrator betoni lidhet drejtpërdrejt me realizimin e shtresës së betonit C16/20. Vibrimi është i nevojshëm për kompaktimin e betonit, eliminimin e boshllëqeve të ajrit dhe sigurimin e një strukture homogjene dhe të qëndrueshme. Përdorimi i vibratorit gjatë betonimit kontribuon në arritjen e cilësisë së kërkuar dhe në respektimin e parametrave teknikë të projektit.

Kërkesa për 1 (një) gjenerator është përcaktuar për garantimin e furnizimit me energji elektrike të pajisjeve të kantierit, në rastet kur rrjeti elektrik nuk është i disponueshëm ose kur furnizimi mund të ndërpritet. Gjeneratori mundëson vijueshmërinë e përdorimit të vibratorit të betonit, matrapikëve dhe pajisjeve të tjera elektrike, duke reduktuar riskun e ndërprerjes së proceseve të punës dhe vonesave në realizimin e kontratës.

Kërkesa për 2 (dy) matrapikë lidhet drejtpërdrejt me punimet e prishjes së shtresave të betonit dhe strukturave prej guri. Disponimi i dy pajisjeve mundëson zhvillimin paralel të proceseve të prishjes dhe përshpejton largimin e elementeve ekzistuese, duke krijuar kushtet për vijimin e punimeve të gërmimit dhe përgatitjes së bazamentit. Kërkesa për dy matrapikë është përcaktuar duke marrë në konsideratë nevojën për realizimin e punimeve brenda afatit dhe mundësinë e angazhimit të njëkohshëm të dy punonjësve.

Përveç mjeteve dhe makinerive të mësipërme, operatori ekonomik duhet të disponojë edhe pajisjet minimale të mbrojtjes dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Kërkesa për 2 (dy) kuti të ndihmës së shpejtë është përcaktuar për të garantuar mundësinë e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti ose dëmtimi gjatë zhvillimit të punimeve. Disponimi i më shumë se një kutie mundëson vendosjen e tyre në pozicione të përshtatshme në varësi të organizimit të kantierit.

Kërkesa për 3 (tre) tabela sinjalistike të përkohshme lidhet me nevojën për të sinjalizuar dhe kufizuar zonat ku zhvillohen punime, duke informuar punonjësit dhe personat e tretë për praninë e rrezikut. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për punimet e prishjes, gjurmimit dhe përdorimit të makinerive, ku kërkohet ndarja dhe sinjalizimi i zonave të punës.

Kërkesa për 8 (tetë) helmata mbrojtëse dhe 8 (tetë) jelekë fosforeshentë është përcaktuar në përputhje me fuqinë minimale prej 8 punonjësish të kërkuar për realizimin e kontratës. Këto pajisje sigurojnë mbrojtjen individuale të punonjësve dhe rrisin dukshmërinë e tyre gjatë punës në kantier, veçanërisht gjatë përdorimit të makinerive, punimeve të gjurmimit, transportit dhe punimeve të tjera me rrezik potencial.

Kërkesa për 2 (dy) fikëse zjarri të lëvizshme është vendosur për të garantuar mundësinë e ndërhyrjes së menjëhershme në rast zjarri që mund të shkaktohet nga përdorimi i pajisjeve elektrike, gjeneratorit, mjeteve mekanike apo proceseve të tjera të punës. Disponimi i tyre kontribuon në rritjen e sigurisë së kantierit dhe në parandalimin e përhapjes së zjarrit.

Në tërësi, mjetet, makineritë dhe pajisjet e kërkuara përbëjnë minimumin teknik të nevojshëm për realizimin e proceseve të parashikuara në preventiv. Kërkesat janë përcaktuar duke pasur parasysh mundësinë e zhvillimit paralel të punimeve të prishjes, gjurmimit, transportit, përgatitjes së shtresave, betonimit dhe shtrimit me gur, si dhe nevojën për respektimin e afatit të ekzekutimit.

Gjithashtu, fakti që mjetet dhe makineritë mund të disponohen në pronësi ose me qira siguron fleksibilitet për operatorët ekonomikë dhe shmang vendosjen e një barre të panevojshme mbi ta për posedimin në pronësi të mjeteve. Kjo mundësi garanton njëkohësisht që operatori ekonomik të ketë në dispozicion mjetet e nevojshme në momentin e realizimit të kontratës.

Për mjetet e rënda, kur ato vihen në dispozicion së bashku me operatorët përkatës, mundësia e disponimit nëpërmjet kontraktimit siguron fleksibilitet në organizimin e burimeve njerëzore dhe teknike, duke garantuar njëkohësisht që makineritë të përdoren nga persona me aftësinë profesionale të nevojshme.

Specifikimet teknike, relacioni teknik, preventivi i punimeve, vizatimet teknike, profilet karakteristike, detajet konstruktive dhe grafiku i ekzekutimit të punimeve për objektin e prokurimit janë hartuar nga projektuesi i licencuar, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, legjislationin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, aktet nënligjore në fuqi për projektimin dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit, standardet teknike shqiptare dhe europiane, si dhe rregullat e praktikës së mirë inxhinierike.

Objekti i investimit konsiston në realizimin e punimeve të ndërhyrjes, rehabilitimit dhe sistemimit të sipërfaqes ekzistuese, me qëllim përmirësimin e gjendjes funksionale dhe teknike të saj, rritjen e sigurisë së përdorimit dhe garantimin e një zgjidhjeje të qëndrueshme dhe me jetëgjatësi. Hartimi i projektit është mbështetur në analizën e gjendjes ekzistuese të objektit dhe terrenit, në kushtet fizike të zonës, si dhe në nevojën për ndërhyrje të kontrolluar në elementët ekzistues. Për këtë arsye, dokumentacioni teknik është përgatitur në mënyrë të tillë që të përcaktojë qartë mënyrën e

realizimit të çdo procesi, materialet që do të përdoren, parametrat teknikë dhe kërkesat që duhet të respektohen gjatë zbatimit të kontratës.

Referuar preventivit, objekti përfshin punime prishjeje të shtresave ekzistuese të betonit dhe strukturave prej guri, punime mbingritjeje të puseve ekzistuese dhe përshtatje të tyre me kuotat e reja të projektit, punime gjurmimi të dheut me krah dhe me mjete mekanike, ngarkimin, transportin dhe largimin e materialeve të rezultuara nga prishjet dhe gjurmimet, përgatitjen dhe sistemimin e terrenit dhe të bazamentit për shtresat e reja konstruktive, realizimin e shtresës së stabilizantit sipas trashësisë dhe parametrave të përcaktuar në projekt, realizimin e shtresës së betonit C16/20, furnizimin, përpunimin, vendosjen dhe fiksimin e hekurit periodik Ø6–10 mm sipas detajeve të armimit, si dhe shtrimin e sipërfaqeve me kalldrëm duke përdorur gurin e zonës, sipas kërkesave të projektit dhe detajeve të zbatimit.

Çdo zë i preventivit është përcaktuar mbi bazën e projektit teknik dhe matjeve përkatëse, duke specifikuar sasinë, njësinë e matjes dhe karakteristikat e procesit ose materialit që do të përdoret. Preventivi përbën bazën ekonomike të procedurës së prokurimit dhe mundëson që operatorët ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre mbi një bazë të njëjtë teknike dhe financiare, duke siguruar krahasueshmërinë e ofertave.

Në mënyrë të veçantë, punimet e prishjes së shtresave të betonit dhe strukturave prej guri janë parashikuar për eliminimin e elementëve ekzistues të amortizuar ose që nuk përputhen me zgjidhjen e re teknike. Këto punime duhet të realizohen në mënyrë të kontrolluar, duke shmangur dëmtimin e elementëve që do të ruhen dhe duke garantuar largimin e plotë të materialeve të rezultuara.

Punimet e gjurmimit me krah dhe me ekskavator janë parashikuar për përgatitjen e terrenit dhe krijimin e kuotave të nevojshme për realizimin e shtresave të reja. Specifikimet teknike përcaktojnë mënyrën e realizimit të gjurmimeve, sistemimin e materialeve dhe kërkesat për përgatitjen e bazamentit.

Shtresa e stabilizantit përbën një element të rëndësishëm të strukturës së sipërfaqes së re. Ajo duhet të realizohet me material të përshtatshëm, të shpërndahet dhe nivelohet në përputhje me kuotat dhe trashësitë e projektit dhe të ngjeshet në mënyrë të përshtatshme për të siguruar qëndrueshmërinë e shtresave të mëvonshme.

Punimet e betonit C16/20 dhe vendosja e hekurit periodik Ø6–10 mm janë parashikuar në përputhje me kërkesat konstruktive të projektit. Armatura duhet të vendoset dhe fiksohet sipas detajeve përkatëse, ndërsa betoni duhet të realizohet, vendoset dhe përpunohet në mënyrë që të arrihen parametrat e kërkuar të rezistencës dhe qëndrueshmërisë.

Shtrimi i kalldrëmit me gurin e zonës është parashikuar si zgjidhje përfundimtare e sipërfaqes, duke marrë në konsideratë kërkesat funksionale, qëndrueshmërinë ndaj përdorimit dhe përshtatjen me karakteristikat e zonës. Guri duhet të jetë i përshtatshëm për përdorim në sipërfaqe të jashtme dhe të plotësojë kërkesat teknike për rezistencën mekanike, qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë.

Specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë që të përcaktojnë qartë karakteristikat minimale të materialeve dhe mënyrën e realizimit të proceseve të punës, duke garantuar që punimet të kryhen sipas parametrave të projektit. Materialet e përdorura, përfshirë stabilizantin, betonin, hekurin e armimit dhe gurin natyror, duhet të jenë të përshtatshme për përdorimin e parashikuar dhe të

shoqërohen me dokumentacionin përkatës që provon cilësinë dhe konformitetin e tyre, sipas kërkesave të dokumentacionit teknik.

Vizatimet teknike, profilet dhe detajet konstruktive janë hartuar në një nivel të përshtatshëm detajimi për të mundësuar interpretimin e njëjtë të punimeve nga operatorët ekonomikë dhe nga personeli përgjegjës për zbatimin dhe kontrollin e tyre. Ato përcaktojnë dimensionet, kuotat, seksionet, trashësitë e shtresave, pozicionimin e armaturës dhe detajet e realizimit të sipërfaqeve të reja.

Përcaktimi i kuotave dhe niveleve të gërmimit, trashësive të shtresës së stabilizantit, pozicionimit të armaturës, shtresës së betonit dhe nivelit përfundimtar të kalldrëmit është i nevojshëm për të garantuar qëndrueshmërinë, funksionalitetin dhe cilësinë e objektit të përfunduar.

Grafiku i ekzekutimit të punimeve është hartuar duke marrë në konsideratë varësinë teknologjike ndërmjet proceseve të ndryshme. Fillimisht parashikohen punimet e prishjes dhe gërmimit, të ndjekura nga transporti dhe largimi i materialeve, përgatitja dhe stabilizimi i bazamentit, realizimi i armaturës dhe betonit dhe, në vijim, shtrimi i kalldrëmit me gurin e zonës dhe sistemimi përfundimtar.

Organizimi i punimeve synon të shmangë ndërhyrjet e panevojshme ndërmjet proceseve të ndryshme, të garantojë vijueshmërinë e punimeve dhe të sigurojë realizimin e tyre brenda afatit kontraktor. Dokumentacioni teknik është hartuar në mënyrë që të sigurojë një kuptim të plotë dhe të njëjtë të objektit të prokurimit nga të gjithë operatorët ekonomikë, duke shmangur paqartësitë dhe interpretimet subjektive. Specifikimet teknike janë formuluar mbi baza objektive dhe funksionale dhe nuk synojnë favorizimin e ndonjë operatori, marke apo prodhuesi të caktuar. Në çdo rast kur përmendet ndonjë standard, produkt ose karakteristikë specifike, ajo duhet të kuptohet e shoqëruar me shprehjen “ose ekuivalente”, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik. Hartimi i dokumentacionit teknik është bërë në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe me nenin 40 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, duke respektuar kërkesat për qartësinë, objektivitetin dhe proporcionalitetin e specifikimeve teknike dhe duke garantuar akses të barabartë për operatorët ekonomikë.

Njëkohësisht, dokumentacioni teknik është hartuar duke respektuar parimet e përcaktuara në nenin 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, përkatësisht transparencën, proporcionalitetin, trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, konkurrencën efektive dhe përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë të fondeve publike.

Në përfundim, Autoriteti Kontraktor vlerëson se specifikimet teknike, preventivi, relacioni teknik, vizatimet, profilet, detajet konstruktive dhe grafiku i ekzekutimit përbëjnë një dokumentacion teknik të plotë dhe të mjaftueshëm për zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe realizimin e objektit. Dokumentacioni përcakton qartë punimet e prishjes, gërmimit, transportit, përgatitjes së shtresave, betonimit, armimit dhe shtrimit me gur, duke krijuar kushte të barabarta për operatorët ekonomikë dhe duke mundësuar përgatitjen e ofertave të krahasueshme.

Nëpërmjet këtij dokumentacioni synohet garantimi i realizimit të punimeve me cilësinë, qëndrueshmërinë dhe sigurinë e kërkuar, si dhe përdorimi me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë i fondeve publike, në funksion të interesit publik dhe të qëllimit të investimit.

NJËSIA E PROKURIMIT